



## DEKLARATA E PARIMEVE NDËRKOMBËTARE TË KATALOGIMIT

### Hyrje

Deklarata e Parimeve – shpesh e njohur si “Parimet e Parisit” – u miratua në Konferencën Ndërkombëtare të Parimeve të Katalogimit në vitin 1961<sup>1</sup>. Qëllimi i saj që të shërbente si bazë për standardizimin ndërkombëtar të katalogimit u arrit plotësisht: shumica e kodeve të katalogimit që ishin zhvilluar kudo në botë deri në atë kohë, i ndoqën këto parime me rigorozitet dhe në një shkallë të lartë.

Pothuaj dyzet vjet më pas, prania e një grupi parimesh katalogimi të përbashkëta u bë më e nevojshme për kataloguesit dhe klientët e tyre për përdorimin e OPAC-ut (Katalogu i Shërbimit të Publikut në Rrjet) në të gjithë botën. Sot, në fillim të shekullit të 21-të, janë bërë përpjekje nga IFLA për hartimin e një deklaratë të re të parimeve të zbatueshme në katalogët në rrjet të bibliotekave dhe më gjerë. Objektivi i parë është përshtatja sa më mirë me kërkesat e përdoruesve të katalogut.

Kjo deklaratë zëvendëson dhe zgjeron qëllimin e Parimeve të Parisit duke filluar nga veprat në formë teksti deri tek të gjitha llojet e materialeve dhe që nga zgjedhja dhe forma e përshkrimit deri tek të gjitha aspektet e të dhënave bibliografike dhe të termave të njësuar të përdorur në katalogët e bibliotekës. Ajo përmban jo vetëm parimet dhe objektivat (siç janë funksionet e katalogut), por edhe rregulla që duhen përfshirë në kodet e katalogimit të të gjitha vendeve, si dhe udhëzime për mundësitë e kërkimit dhe të gjetjes.

Përmbajta e Deklaratës:

1. Qëllimi
2. Parime të përgjithshme
3. Entitetet, atributet dhe lidhjet
4. Objektivat dhe funksionet e katalogut
5. Përshkrimi bibliografik
6. Pikat hyrëse
7. Bazat e mundësive të kërkimit

Kjo deklaratë ndërtohet duke u bazuar në traditën e shkëlqyer të katalogimit në të gjithë botën<sup>2</sup> si dhe në modelin konceptor të IFLA-s *Functional Requirements for Bibliographic Records* (FRBR)<sup>3</sup>

Besojmë se kjo deklaratë do të rrisë përdorimin e përbashkët ndërkombëtar të të dhënave

<sup>1</sup> International Conference on Cataloguing Principles (Paris: 1961). *Report*. - London: International Federation of Library Associations, 1963, p. 91-96. E disponueshme edhe në: *Library Resources and Technical Services*, v. 6 (1962), p. 162-167; dhe *Statement of principles adopted at the International Conference on Cataloguing Principles, Paris, October, 1961*. - Annotated edition / with commentary and examples by Eva Verona. - London: IFLA Committee on Cataloguing, 1971.

<sup>2</sup> Cutter, Charles A.: *Rules for a Dictionary Catalog*. 4th ed., rewritten. Washington, D.C.: Government Printing office. 1904, Ranganathan, S.R.: *Heading and Canons*. Madras [India]: S. Viswanathan, 1955, and Lubetzky, Seymour. *Principles of Cataloging. Final Report. Phase I: Descriptive Cataloging*. Los Angeles, Calif.: University of California, Institute of Library Research, 1969.

<sup>3</sup> *Functional Requirements for Bibliographic Records: Final report*. - Munich: Saur, 1998. (IFLA UBCIM publications new series; v. 19) Available on the IFLA Web site: <http://www.ifla.org/II/s13/frbr/> (Sept. 1997, as amended and corrected through February 2008)

The FRBR model will soon be extended through *Functional Requirements for Authority Data* (FRAD) and *Functional Requirements for Subject Authority Data* (FRSAD)



bibliografike dhe të termave të njësuar dhe do të udhëheqë hartuesit e rregullave të katalogimit në punën e tyre për zhvillimin e një kodi ndërkombëtar katalogimi.

## 1. Qëllimi

Parimet e paraqitura synojnë të ndihmojnë në zhvillimin e kodeve të katalogimit. Ato zbatohen në regjistrimet bibliografike, në ato të termave të njësuar dhe tek katalogët korrentë të bibliotekave. Parimet mund të zbatohen gjithashtu tek bibliografitë dhe skedarët e të dhënave të krijuar nga bibliotekat, arkivat, muzetë etj.

Ato kanë qëllim të sigurojnë rregullsi në katalogimin përshkrues dhe në atë lëndor të burimeve bibliografike të të gjitha llojeve.

## 2. Parime të përgjithshme

Janë disa parime në të cilat bazohet hartimi i kodeve të katalogimi<sup>4</sup>. Parimi më i rëndësishëm është komoditeti i përdoruesit<sup>5</sup>.

**2.1. Komoditeti i përdoruesit.** Gjatë marrjes së vendimeve për hartimi e përshkrimeve dhe të formave të kontrolluara të emrave për akses, duhet pasur parasysh përdoruesi.

**2.2. Përdorimi i përgjithshëm.** Fjalori i përdorur në përshkrime dhe akses duhet të jetë në përshtatje me atë të shumicës së përdoruesve.

**2.3. Paraqitja.** Përshkrimet dhe format e kontrolluara të emrave duhet të bazohen në mënyrën në të cilën një entitet përshkruan veten.

**2.4. Saktësia.** Entiteti i përshkruar duhet të paraqitet me saktësi.

**2.5. Mjaftueshmëria dhe domosdoshmëria.** Duhet të përfshihen vetëm ata elementë të përshkrimit dhe forma të kontrolluara të emrave për akses që janë të nevojshëm për plotësimin e detyrave të përdoruesit dhe janë themelore për identifikimin në mënyrë unike të një entiteti.

**2.6. Rëndësia.** Elementet e të dhënave duhet të jenë bibliografikisht të rëndësishëm.

**2.7. Ekonomia.** Kur ekzistojnë mënyra alternative për të arritur një qëllim, i jepet përparësi asaj mënyre që është më ekonomike (d.m.th. me kosto më të ulët ose mënyra më e thjeshtë).

**2.8. Uniformiteti dhe standardizimi.** Përshkrimet dhe ndërtimi i pikave hyrëse duhet të jenë të standardizuara në nivelin më të lartë të mundshëm. Kjo siguron uniformitet më të madh, gjë që rrit mundësinë e përdorimit të përbashkët të të dhënave bibliografike dhe të atyre të termave të njësuar.

**2.9. Integriteti.** Përshkrimi i të gjitha llojeve të materialeve dhe të formave të kontrolluara të emrave të entiteteve duhet të bazohet në rregulla të përbashkëta sa herë që është e mundur.

Rregullat në një kod katalogimi duhet të jenë të argumentuara dhe jo arbitrare. Mund të ndodhë që në situata të caktuara këto parime të kundërshtojnë njeri tjetrin, ndaj duhet gjetur një zgjidhje e argumentuar, praktike.

## 3. Entitetet, atributet, dhe lidhjet

Një kod katalogimi duhet të ketë parasysh entitetet, atributet dhe lidhjet siç përcaktohen në modelet konceptore të universit bibliografik<sup>6</sup>.

<sup>4</sup> Bazuar në literaturën bibliografike, veçanërisht ato të Ranganathan dhe Leibniz siç përshkruhet në Svenonius, Elaine. *The Intellectual Foundation of Information Organization*. Cambridge, Mass.: MIT Press, 2000, p. 68. Për sa i përket thesarit lëndor, zbatohen parime të tjera, por ende nuk janë përfshirë në këtë deklaratë.

<sup>5</sup> Parimet 2.2 deri 2.9 nuk janë sipas një rregulli të caktuar

<sup>6</sup> Modelet konceptore të IFLA's janë FRBR, FRAD dhe FRISAD



### 3.1. Entitetet

Në të dhënat bibliografike dhe ato të termave të njësuar mund të paraqiten entitetet:

Vepra  
Shprehja  
Manifestimi  
Njësia<sup>7</sup>  
Person  
Familje  
Koncept<sup>8</sup>  
Objekt  
Ngjarje  
Vend<sup>9</sup>.

### 3.2. Atributet

Atributet që identifikojnë çdo entitet duhet të përdoren si elemente të dhënash.

### 3.3. Lidhjet

Duhet të identifikohen lidhjet ndërmjet entiteteve bibliografikisht të rëndësishme.

## 4. Objektivat dhe funksionet e katalogut <sup>10</sup>

Katalogu duhet të jetë instrument efektiv dhe efikas që i mundëson përdoruesit:

**4.1. të gjejë** regjistrimet bibliografike në një koleksion si rezultat i kërkimit duke përdorur atributet ose lidhjet e burimeve:

**4.1.1. të gjejë** një burim të vetëm

**4.1.2. të gjejë** një grup burimesh që përfaqësojnë

të gjitha burimet që i përkasin të njëjtës vepër  
të gjitha burimet që materializojnë të njëjtën shprehje  
të gjitha burimet që tregojnë të njëjtin manifestim  
të gjitha veprat dhe shprehjet për një person, familje, ose organizëm  
të gjitha burimet për një subjekt të dhënë  
të gjitha burimet e përcaktuara sipas kriterëve të tjera (si gjuha, vendi i botimit, data e botimit, tipi i përmbajtjes, tipi i mbartësit, etj.) të përdorura zakonisht për të kufizuar rezultatin e kërkimit;

**4.2. të identifikojë** një burim bibliografik ose agjent (d.m.th të konfirmojë se entiteti i përshkruar korrespondon me entitetin e kërkuar, ose të bëjë dallimin ndërmjet dy apo më shumë entiteteve me karakteristika të ngjashme);

<sup>7</sup> Vepra, shprehja, manifestimi dhe njësia janë entitetet e Grupit 1 të përshkuara në modelin FRBR.

<sup>8</sup> Person, familje dhe organizëm janë entitetet e Grupit 2 të përshkuara në modelet FRBR dhe FRAD.

<sup>9</sup> Koncept, objekt, ngjarje dhe vend janë entitetet e Grupit 3 të përshkuara në modelin FRBR. Njeri nga entitetet mund të ketë lidhje me një vepër për sa i përket subjektit.

<sup>10</sup> 4.1-4.5 bazohen në: Svenonius, Elaine. *The Intellectual Foundation of Information Organization*. Cambridge, Mass.: MIT Press, 2000.



- 4.3. të zgjedhë** një burim bibliografik që përshtatet me kërkesat e përdoruesit (d.m.th. të zgjedhë një burim që plotëson kërkesat e përdoruesit lidhur me mjedisin, përmbajtjen, bartësin etj., ose të përjashtojë një burim që nuk përshtatet me kërkesat e përdoruesit);
- 4.4. të gjejë** ose sigurojë akses në një njësi të përshkruar (d.m.th. të japë informacion që i mundëson përdoruesit të gjejë një njësi përmes blerjes, huazimit etj., ose të aksesojë njësinë në mënyrë elektronike në një burim në distancë përmes lidhjes në rrjet); ose të aksesojë, gjejë ose sigurojë të dhënat e njësuara ose ato bibliografike;
- 4.5. Të lundrojë** në një katalog dhe më tej (kjo në sajë të vendosjes logjike të të dhënave bibliografike dhe të termave të njësuar, dhe mënyrave të qarta për ta shfletuar, përfshirë paraqitjen e lidhjeve ndërmjet veprave, shprehjeve, manifestimeve, njësive, personave, familjeve, organizmave, koncepteve, objekteve, ngjarjeve dhe vendeve).

## 5. Përshkrimi bibliografik

- 5.1.** Në përgjithësi duhet krijuar një përshkrim i veçantë bibliografik për çdo manifestim.
- 5.2.** Një përshkrim bibliografik duhet të bazohet tek njësia si shembull tipik i manifestimit dhe mund të përmbajë artibutet që i përkasin veprës(ave) dhe shprehjes(ve) që materializon.
- 5.3.** Të dhënat përshkruese duhet të bazohen në një standard të miratuar në nivel ndërkombëtar<sup>11</sup>.
- 5.4.** Përshkrimet mund të kenë nivele të ndryshme plotësie, në varësi të qëllimit të katalogut ose skedarit bibliografik. Informacioni për nivelin e plotësisë duhet t'u bëhet i ditur përdoruesve.

## 6. Pikat hyrëse

### 6.1. Rregulla të përgjithshme

Pikat hyrëse për gjetjen e të dhënave bibliografike dhe të termave të njësuar duhet të formulohen sipas parimeve të përgjithshme (shih **2. Parime të përgjithshme**). Ato mund të jenë të kontrolluara ose të pakontrolluara.

- 6.1.1.** Pikat hyrëse të kontrolluara duhet të jepen për format e autorizuara dhe variante të formave të emrave për entitete si persona, familje, organizma, vepra, shprehje,

<sup>11</sup> Për komunitetin bibliotekar, standard ndërkombëtar është *International Standard Bibliographic Description*.



manifestime, njësi, koncepte, objekte, ngjarje, dhe vende. Pikat hyrëse të kontrolluara sigurojnë uniformitetin e nevojshëm për renditjen e regjistrimeve bibliografike për grupe burimesh.

**6.1.1.1.** Regjistrimet e termave të njësuar krijohen për të kontrolluar format e autorizuara të emrave, variantet e formave të emrave dhe identifikuesit e përdorur si pika hyrëse.

**6.1.2.** Pikat hyrëse të pakontrolluara mund të jepen si të dhëna bibliografike për emrat, titujt (p.sh. titulli siç gjendet në një manifestim), kodet, fjalët kyç, etj., të pakontrolluara në regjistrimet e termave të njësuar.

## **6.2. Zgjedhja e pikave hyrëse**

**6.2.1.** Merren si pika hyrëse në një **regjistrim bibliografik** pikat hyrëse të autorizuara për veprat dhe shprehjet (të kontrolluara) të përfshira në burim, titujt e manifestimeve (zakonisht të pakontrolluar) dhe pikat hyrëse të autorizuara për krijuesit e veprave.

**6.2.1.1.** Organizmi si krijues: Një organizëm duhet konsideruar si krijues i atyre veprave që shprehin mendimin ose veprimtarinë kolektive të organizmit, ose kur formulimi i titullit, i lidhur me natyrën e veprës lë të kuptohet qartë se organizmi është kolektivisht përgjegjës për përmbajtjen e veprës. Kështu veprohet edhe kur vepra është nënshkruar nga një person me kompetencat e një zyrtari të organizmit.

**6.2.2.** Pika hyrëse duhet të krijohen në **regjistrimet bibliografike** edhe për format e autorizuara të emrave të personave, familjeve, organizmave dhe subjekteve që konsiderohen të rëndësishëm për gjetjen dhe identifikimin e regjistrimit bibliografik që përshkruhet.

**6.2.3.** Forma e autorizuar e emrit të entitetit si dhe variante të formave të emrit vendosen si pika hyrëse në një regjistrim termi të njësuar.

**6.2.4.** Mund të bëhen hyrje shtesë për emrat e entiteteve në lidhshmëri.

## **6.3. Pikat hyrëse të autorizuara**

Pika hyrëse e autorizuar për emrin e një entiteti duhet të regjistrohet në një regjistrim termi të njësuar së bashku me identifikuesit e entitetit dhe variantet e formave të emrit. Mund të jetë e nevojshme një pikë hyrëse e autorizuar si formë që shfaqet automatikisht.

**6.3.1.** Pikat hyrëse të autorizuara duhet të ndërtohen sipas standardit.

### **6.3.2. Gjuha dhe shkrimi i pikave hyrëse të autorizuara**



**6.3.2.1.** Kur emrat janë shprehur në gjuhë dhe/ose shkrime të ndryshme, përparësi për një pikë hyrëse të autorizuar për emrin i duhet dhënë informacionit të gjetur në manifestimet e veprës të shprehura në gjuhën dhe shkrimin origjinal;

**6.3.2.1.1.** por kur gjuha ose shkrimi origjinal nuk përdoret në katalog, pika hyrëse e autorizuar mund të bazohet në format e manifestimeve ose në burimet referuese në një nga gjuhët ose shkrimet më të përshtatshme për përdoruesit e katalogut.

**6.3.2.1.2.** Aksesit duhet të jepet në gjuhën dhe shkrimin origjinal sa herë që është e mundur, me anë të një pike hyrëse të kontrolluar, ose si formë e autorizuar e emrit ose variant i formës së emrit.

**6.3.2.2.** Nëse preferohet transliterimi, duhet të përdoret standardi ndërkombëtar i konvertimit të shkrimit.

### **6.3.3. Zgjedhja e pikës hyrëse të autorizuar**

Emri i preferuar si pikë hyrëse e autorizuar për një entitet duhet të bazohet tek emri që identifikon entitetin në mënyrë konsekuente, që mund të jetë emri që gjendet më shpesh në manifestime, ose emri i pranuar si më i përshtatshëm për përdoruesit e katalogut (p.sh. 'emër konvencional') në formën që gjendet në burimet referuese.

#### **6.3.3.1. Zgjedhja e pikës hyrëse të autorizuar për person, familje, organizëm**

Kur një person, familje ose organizëm përdor emra të ndryshëm, ose variante të formave të emrit, duhet të zgjidhet vetëm një emër ose një formë e emrit si bazë për pikën hyrëse të autorizuar të çdo entiteti të veçantë.

**6.3.3.1.1.** Kur në manifestime dhe/ose në burime referuese gjenden variante të formave të emrit, dhe këto variante nuk bazohen në paraqitje të ndryshme të të njëjtit emër (p.sh. formë e plotë ose e shkurtuar), i jepet përparësi

**6.3.3.1.1.1.** emrit më shumë të njohur (ose 'konvencional') dhe jo emrit zyrtar, kur kjo mund të përcaktohet; ose

**6.3.3.1.1.2.** emrit zyrtar kur nuk ekziston një emër më i njohur ose konvencional.

**6.3.3.1.2.** Kur një organizëm ka përdorur në periudha të ndryshme emra të ndryshëm që nuk mund të quhen variante të parëndësishme të një emri, çdo entitet i identifikuar me një emër të ndryshuar dukshëm, duhet konsideruar entitet i ri. Të dhënat korresponduese të termit të njësuar për çdo entitet duhet të lidhen mes tyre, duke lidhur format e autorizuar të hershme me ato të vonshme të emrit të organizmit.

#### **6.3.3.2. Zgjedhja e pikës hyrëse të autorizuar për veprën dhe shprehjen**

Kur një vepër ka disa tituj, njeri prej tyre duhet preferuar si bazë për pikën hyrëse të autorizuar për veprën/shprehjen.

### **6.3.4. Forma e emrit për pikat hyrëse të autorizuar**

#### **6.3.4.1. Forma e emrit për personat**

Kur emri i personit përbëhet nga disa fjalë, zgjedhja e fjalës së parë si pikë hyrëse e autorizuar duhet bazuar në traditën e vendit dhe gjuhën që janë më shumë të lidhura me këtë person, siç gjendet në manifestimet ose burimet referuese.



#### **6.3.4.2. Forma e emrit për familjet**

Kur emri i një familjeje përbëhet nga disa fjalë, zgjedhja e fjalës së parë si pikë hyrëse e autorizuar duhet bazuar në traditën e vendit dhe gjuhën që janë më shumë të lidhura me këtë familje, siç gjendet në manifestimet ose burimet referuese.

#### **6.3.4.3. Forma e emrit për organizmat**

Për pikën hyrëse të autorizuar të një organizmi, emri duhet të jepet në renditje të drejtë, siç gjendet në manifestimet ose burimet referuese, përveç rasteve

**6.3.4.3.1.** kur organizmi është pjesë e një autoriteti shtetëror ose territorial, pika hyrëse e autorizuar duhet të përmbajë formën aktuale të përdorur të emrit të territorit në gjuhën dhe shkrimin që plotëson më mirë kërkesat e përdoruesve të katalogut;

**6.3.4.3.2.** kur emri i organizmit përfaqëson një vartësi, ose funksion vartës, apo është i pamjaftueshëm për të identifikuar organizmin vartës, pika hyrëse e autorizuar duhet të fillojë me emrin e organit superior.

#### **6.3.4.4. Forma e emrit për veprat/shprehjet**

Pikë hyrëse e autorizuar për një vepër, shprehje, manifestim ose njësi mund të jetë një titull që mund të qëndrojë vetëm, ose titull i kombinuar me pikën hyrëse të autorizuar për krijuesin(it) e veprës.

#### **6.3.4.5. Dallimi ndërmjet emrave**

Kur është e nevojshme të dallohet një entitet nga entitete të tjera me të njëjtin emër, duhet të vendosen veçori identifikuese si pjesë të pikës hyrëse të autorizuar të entitetit. Të njëjtat veçori identifikuese mund të vendosen edhe si pjesë të varianteve të formave të emrit.

### **6.4. Variante të emrave dhe variante të formave të emrave**

Pavarësisht nga emri i zgjedhur si pikë hyrëse e autorizuar, duhet të futen edhe variante të emrit dhe variante të formave të emrit për akses të kontrolluar.

## **7. Elementet bazë për funksionimin e kërkimit**

### **7.1. Kërkimi**

Pikat hyrëse janë elementet e regjistrimeve bibliografike dhe të termave të njësuar që 1) sigurojnë kërkim të sigurt të regjistrimeve bibliografike dhe të atyre të termave të njësuar, dhe 2) kufizojnë rezultatet e kërkimit.

#### **7.1.1. Mënyrat e kërkimit**

Emrat, titujt dhe subjektet duhet të jenë të kërkueshëm dhe të gjetshëm me anë të ndonjë prej mënyrave të zbatueshme në katalogun e bibliotekës ose në skedarin bibliografik (me formën e plotë të emrave, me fjalë kyç, me fraza, me prerje të fjalës, me identifikues etj.).

#### **7.1.2. Pikat hyrëse kryesore**

Pika hyrëse kryesore janë ato që bazohen në atributet dhe lidhjet kryesore të çdo entiteti në regjistrimin bibliografik dhe në atë të termit të njësuar.

##### **7.1.2.1. Pikat hyrëse kryesore në regjistrimet bibliografike janë:**



pikë hyrëse e autorizuar për emrin e krijuesit ose atij që është i pari kur janë më shumë se një emra krijuesish  
 pikë hyrëse e autorizuar për veprën/shprehjen (kjo mund të përfshijë dhe pikën hyrëse të autorizuar për krijuesin)  
 titulli kryesor ose titulli i dhënë i manifestimit  
 viti (et) i botimit ose i daljes së manifestimit  
 terma subjekti të kontrolluar dhe/ose numra klasifikimi të veprës  
 numra standard, identifikues, dhe 'tituj kyç' për entitetin e përshkruar.

**7.1.2.2. Pikat hyrëse kryesore në regjistrimet e termave të njësuar janë:**

emri ose titulli i autorizuar i entitetit  
 identifikuesit e entitetit  
 variante të emrave dhe variante të formave të emrit ose të titullit të entitetit.

**7.1.3. Pika hyrëse shtesë**

Atribute të fushave të tjera të përshkrimit bibliografik ose të termit të njësuar mund të shërbejnë si pika hyrëse fakultative ose si mjete kufizimi për kërkim.

**7.1.3.1. Në regjistrimet bibliografike këtotribute përfshijnë, në mënyrë jo të kufizuar:**

emrat e krijuesve përveç të parit  
 emrat e personave, familjeve, ose organizmave jo në rolin e krijuesve (p.sh. ekzekutues)  
 variante të titullit (p.sh. tituj paralel, titujt e kreut)  
 pikë hyrëse e autorizuar për serinë  
 identifikues të regjistrimit bibliografik  
 gjuha e shprehjes e panishme në manifestim  
 vendi i botimit  
 tipi i përmbajtjes  
 tipi i bartësit.

**7.1.3.2. Në regjistrimet e termave të njësuar këtotribute përfshijnë, në mënyrë jo të kufizuar:**

emrat ose titujt e entiteteve në lidhshmëri  
 identifikuesit e regjistrimit të termit të njësuar.

**7.2. Gjetja**

Kur gjenden disa regjistrime me të njëjtën pikë hyrëse, regjistrimet duhet të shfaqen në një renditje logjike, të përshtatshme për përdoruesit e katalogut, ku preferohet ajo sipas standardit të gjuhës dhe shkrimit të pikës hyrëse.





## Fjalori i ICP

Ky fjalor përmban terma që gjenden në Parimet Ndërkombëtare të Katalogimit (ICP) dhe që përdoren në mënyrë specifike (jo përkufizime të fjalorit të zakonshëm). Në mbyllje janë terma të përdorur tek Parimet e Parisit ose në rregulla të tjera më të hershme të katalogimit, për të cilat anëtarët e IME ICC dëshirojnë të venë në dukje se nuk përdoren tashmë në ICP.

BT = Term më i gjerë; NT = Term më i ngushtë; RT = Term në lidhshmëri

**Agjent** [agent] - Person (autor, botues, skulptor, redaktor, drejtues, kompozitor, etj.) ose grup (familje, organizatë, korporatë, bibliotekë, orkestër, krahinë, federatë etj.) ose robot (pajisje për regjistrimin e kushteve të motit, program software për përkthim automatik etj.) që luan rol në ekzistencën e një burimi.

[Burimi: DCMI Agents Working Group, përkufizim i punës, i modifikuar]

*Shih edhe Krijues [NT]*

**Atribut** [attribute] - Karakteristikë e një entiteti. Atributi mund të jetë i brendaqënësishëm në një entitet ose i jashtëm.

[Burimi: FRBR]

**Bibliografikisht i rëndësishëm** [bibliographically significant] - Cilësi e një entiteti, atributi ose lidhjeje që ka kuptim ose vlerë të veçantë në kontekstin e burimeve bibliografike.

[Burimi: IME ICC]

**Burim bibliografik** [bibliographic resource] - Entitet në sferën bibliotekare ose në koleksione të ngjashme që është produkt i përpjekjeve intelektuale ose artistike. Burimet bibliografike janë entitetet e Grupit 1 në modelin FRBR: vepra, shprehja, manifestimi dhe njësia.

[Burimi: IME ICC]

**Emër** [name] - Karakter, fjalë ose grup fjalësh dhe/ose karakteresh me anë të të cilave njihet një entitet. Përfshin fjalët/karakteret që emërtojnë një person, familje, organizëm; termat me anë të të cilave njihen konceptet, objektet, ngjarjet, vendet; titullin që i është dhënë një veprë, shprehjeje, manifestimi ose njësie. Përdoret si bazë për një pikë hyrëse.

[Burimi: FRBR modifikuar në FRAD]

*Shih edhe Emër konvencional [NT], Emër i preferuar [NT], Formë e autorizuar e emrit [NT], Pikë hyrëse [RT], Pikë hyrëse e kontrolluar [RT], Variant i formës së emrit [NT]*

**Emër i preferuar** [preferred name] - Emër i një entiteti i zgjedhur sipas rregullave ose standardeve, i përdorur si bazë për ndërtimin e një pike hyrëse të autorizuar për entitetin.

*Shih edhe Emër [BT], Emër konvencional [RT], Formë e autorizuar e emrit [RT],*

*Pikë hyrëse e autorizuar [RT]*

[Burimi: IME ICC]



**Emër konvencional** [conventional name] - Emër, i ndryshëm nga emri zyrtar, me anë të të cilit një organizëm, vend ose objekt është bërë i njohur.

[Burimi: Fjalori i modifikuar i AACR2 Revision, 2002]

*Shih edhe* **Emër [BT], Formë e autorizuar e emrit [RT], Variant i formës së emrit [RT]**

**Entitet** [entity] - Diçka që ka karakter unik dhe të pavarur, diçka që ka ekzistencë të pavarur ose të veçantë; abstraksion, koncept ideal, objekt i mendimit ose objekt idealist.

[Burimi: Webster's 3<sup>rd</sup>]

Shembujt e tipeve të entiteteve në FRBR dhe FRAD përfshijnë produkte të veprimtarive intelektuale ose artistike (vepra, shprehja, manifestimi dhe njësia); dhe agjentët (p.sh. persona, familje, organizma) përgjegjës për krijimin e përmbajtjes intelektuale ose artistike, për prodhimin dhe shpërndarjen e përmbajtjes në formë fizike, ose për mbajtjen në kujdestari të produktit; ose subjekti i një vepre (vepër, shprehje, manifestim, njësi, person, familje, organizëm, koncept, objekt, ngjarje, vend).

[Burimi: IME ICC]

**Familje** [family]- Dy ose më shumë persona të afërm nga lindja, martesë, birësi ose status tjetër ligjor, ose që e paraqesin veten si familje.

[Burimi: FRAD, modifikuar nga IME ICC]

**Formë e autorizuar e emrit** [authorized form of name] - Forma e emrit e zgjedhur si pikë hyrëse e autorizuar (e njësuar) për një entitet.

*Shih edhe:* **Emër [BT], Emër i preferuar [RT], Emër konvencional [RT], Pikë hyrëse e autorizuar [RT], Variant i formës së emrit [RT]**

**Identifikues** [identifier] - Numër, kod, fjalë, frazë, markë, emblemë, etj., e bashkëlidhur me një entitet dhe shërben për ta dalluar atë nga entitete të tjera brenda fushës të cilës i përket identifikuesi.

[Burimi: FRAD]

**Katalogim lëndor** [subject cataloguing] - Pjesë e katalogimit që përcakton termat e subjektit të kontrolluara dhe/ose numrat e klasifikimit.

[Burimi: IME ICC]

*Shih edhe* **Katalogim përshkrues [RT]**

**Katalogim përshkrues** [descriptive cataloguing] -Pjesa e katalogimit që jep të dhënat përshkruese dhe pikat hyrëse jo për subjekte.

[Burimi: IME ICC]

*Shih edhe* **Katalogim lëndor [RT], Përshkrim bibliografik [RT]**

**Koleksion** [collection] - 1. Grup real ose virtual prej dy ose më shumë veprash ose pjesë të veprave të bashkuara ose të botuara së bashku. 2. Grup real ose virtual burimesh bibliografike që mbahen ose janë krijuar nga një institucion i caktuar.

[Burimi: IME ICC]

**Koncept** [concept] - Nacion ose ide abstrakte.

[Burimi: FRAD (lidhur me subjektet), FRBR]



**Krijues** [creator] - Person, familje ose organizëm përgjegjës për përmbajtjen intelektuale ose artistike të një vepre.

[Burimi: IME ICC]

*Shih edhe* **Agjent [BT]**

**Lidhshmëri** [relationship] -Marrëdhënie specifike ndërmjet entiteteve.

[Burimi: bazuar në FRBR]

**Manifestim** [manifestation] - Materializimi fizik i shprehjes së një vepre.

[Burimi: FRAD, FRBR]

Një manifestim mund të simbolizojë një koleksion veprash, një vepër të vetme, ose një pjesë përbërëse të një vepre. Manifestimet mund të shfaqen në një ose më shumë njësi fizike.

[Burimi: IME ICC]

**Ngjarje** [event] - Veprim ose ndodhi.

[Burimi: FRAD (ato që nuk veprojnë si organizma konsiderohen subjekte), FRBR]

**Njësi** [item] - Një ekzemplar i vetëm i një manifestimi.

[Burimi: FRAD, FRBR]

**Objekt** [object] - Send material.

[Burimi: FRBR]

**Organizëm** [corporate body] - Organizatë ose grup personash dhe/ose organizatash të identifikuar me një emër të veçantë dhe që vepron, ose mund të veprojnë, si një njësi.

[Burimi: modifikuar nga FRAD, FRBR]

**Person** [person] - Identitet individual ose unik i vendosur ose përshtatur nga një individ ose grup.

[Burimi: FRBR modifikuar në FRAD, modifikuar nga IME ICC]

**Përshkrim bibliografik** [bibliographic description] - Grup të dhënash bibliografike që identifikojnë një burim bibliografik.

[Burimi: ISBD e modifikuar]

*Shih edhe:* **Katalogimi përshkrues [RT]**

**Pikë hyrëse** [access point] – Emër, term, kod etj., përmes të cilit kërkohen dhe identifikohen të dhënat bibliografike ose ato të termave të njësuar.

[Burimi:GARR modifikuar nga FRAD dhe IME ICC]

*Shih edhe* **Emër [RT], Pikë hyrëse e autorizuar [NT], Pikë hyrëse e kontrolluar [NT], Pikë hyrëse e pakontrolluar [NT], Pikë hyrëse kryesore [NT], Pikë hyrëse shtesë [NT], Variant i formës së emrit [NT].**

**Pikë hyrëse e autorizuar** [authorized access point] - Pika hyrëse e kontrolluar e preferuar për një entitet, e vendosur dhe e ndërtuar sipas rregullave ose standardeve.

[Burimi: IME ICC]

*Shih edhe:* **Emër i preferuar [RT], Formë e autorizuar e emrit [RT], Pikë hyrëse [BT], Pikë hyrëse e kontrolluar [BT], Variant i formës së emrit [RT].**



**Pikë hyrëse e kontrolluar** [controlled access point] - Pikë hyrëse e regjistruar në një regjistrim termi të njësuar.

[Burimi: GARR e modifikuar]

Pikat hyrëse të kontrolluara përfshijnë format e autorizuara të emrave si dhe ato të përcaktuara si variante të formave të emrave. Ato mund:

- të bazohen në emrat vetjakë, të familjeve ose organizmave,
- të bazohen në emrat (d.m.th. titujt) e veprave, shprehjeve, manifestimeve dhe njësive,
- të jenë kombinim i dy emrave, si në rastin e një pike hyrëse emër/titull për të paraqitur një vepër që kombinon emrin e krijuesit me titullin e veprës,
- të bazohen në termat për ngjarjet, objektet, konceptet dhe vendet,
- të bazohen në identifikuesit, siç janë numrat standardë, indekset e klasifikimit etj. Emrit mund t'i shtohen elemente të tjerë (si p.sh. datat) për të bërë dallimin mes entiteteve me emra të njëjtë ose të ngjashëm.

[Burimi: FRAD – vë në dukje se modeli përqëndrohet në emrat dhe termat e kontrolluar përmes një skedari termash të njësuar.]

*Shih edhe* **Emër [RT], Pikë hyrëse [BT], Pikë hyrëse e autorizuar [NT], Pikë hyrëse e pakontrolluar [RT], Variant i formës së emrit [NT].**

**Pikë hyrëse e standardizuar** [normalized access point]

*Shih* **Pikë hyrëse e autorizuar** [authorized access point]

**Pikë hyrëse e pakontrolluar** [uncontrolled access point] – Pikë hyrëse që nuk është kontrolluar nga një regjistrim termi të njësuar.

[Burimi: IME ICC]

*Shih edhe* **Pikë hyrëse [BT], Pikë hyrëse e kontrolluar [RT]**

**Pikë hyrëse kryesore** [essential access point] - Pikë hyrëse bazuar në një atribut kryesor ose lidhje të një entiteti në një regjistrim bibliografik ose regjistrim termi të njësuar që siguron gjetjen dhe identifikimin e atij regjistrimi.

[Burimi: IME ICC]

*Shih edhe* **Pikë hyrëse [BT], Pikë hyrëse shitesë [RT]**

**Pikë hyrëse shitesë** [additional access point] - Pikë hyrëse që mund të përdoret përveç pikës hyrëse kryesore për të zgjeruar kërkimin e të dhënave bibliografike ose atyre të termave të njësuar.

[Burimi: IME ICC]

*Shih edhe* **Pikë hyrëse [BT], Pikë hyrëse kryesore [RT]**

**Regjistrim bibliografik** [bibliographic description] - Grup me elemente të dhënash që përshkruajnë dhe sigurojnë akses në një burim bibliografik, dhe identifikojnë veprat dhe shprehjet që lidhen me të.

[Burimi: IME ICC]

**Regjistrim termi të njësuar** [authority record] – Grup me elemente të dhënash që identifikojnë një entitet dhe mund të përdoren për të lehtësuar aksesin në pikën hyrëse të autorizuar (të njësuar) për atë entitet ose shfaqjen e ndonjë pikë hyrëse për entitetin.

[Burimi: IME ICC]

**Shprehje** [expression] - Realizimi intelektual ose artistik i një vepre.

[Burimi: FRAD, FRBR]



**Tipi i bartësit** [type of carrier] - Përcaktim që pasqyron formatin e mjedisit depozitues dhe ruajtës të një bartësi, të kombinuar me tipin e pajisjes ndërmjetëse që duhet për ta parë, interpretuar, dëgjuar etj., përmbajtjen e burimit. Tipi i bartësit pasqyron atributet e një manifestimi.

[Burimi: modifikuar nga RDA Glossary, janar 2008]

**Tipi i përmbajtjes** [content type] - Përcaktim që pasqyron formën themelore të komunikimit me të cilën shprehet përmbajtja dhe sensin human të të kuptohet. Tipi i përmbajtjes pasqyron atributet si të veprës ashtu dhe të shprehjes.

[Burimi: Fjalori për RDA modifikuar në janar 2008]

**Titull kyç** [key title] - Emri unik i caktuar për një burim në vazhdim nga Rrjeti ISSN dhe i lidhur në mënyrë të pandashme me ISSN-në e tij. Titulli kyç mund të jetë i njëjtë me titullin kryesor, ose për të arritur unifikim, ai mund të ndërtohet duke shtuar elemente identifikimi dhe/ose kualifikimi, si p.sh. emri i organit që e nxjerr, vendi i botimit, të dhëna për botimin.

[Burimi: ISBD]

**Univers bibliografik** [bibliographic universe] - Fushë që përfshin koleksionet e bibliotekave, arkivave, muzeve dhe të bashkësive të tjera të informacionit.

[Burimi: IME ICC]

**Variant i formës së emrit** [variant form of name] - Formë e emrit që nuk është zgjedhur si pikë hyrëse e autorizuar për një entitet. Ajo mund të përdoret për të aksesuar regjistrimin e termit të njësuar për entitetin ose të jetë e pranishme si lidhje me pikën hyrëse të autorizuar.

[Burimi: IME ICC]

*Shih edhe* **Emër [BT], Emër konvencional [RT], Formë e autorizuar e emrit [RT], Pikë hyrëse [BT], Pikë hyrëse e autorizuar [RT], Pikë hyrëse e kontrolluar [BT].**

**Vend** [place] - Vendndodhje.

[Burimi: FRBR]

**Vepër** [work] - Krijim i veçantë intelektual ose artistik (që është përmbajtja intelektuale ose artistike).

[Burimi: FRAD, FRBR, modifikuar nga IME ICC]

## **Burimet**

AACR2 - *Anglo-American Cataloguing Rules*. - 2nd edition, 2002 revision. - Ottawa:

Canadian Library Association; London: Chartered Institute of Library and Information Professionals; Chicago: American Library Association, 2002-2005.

DCMI Agents Working Group - Dublin Core Metadata Initiative, Agents Working Group. From Web page, 2003 (working definitions): [http://dublincore.org/arouDs/aaents/Final report available online at: http://dublincore.org/documents/dcmi-terms/#classes-Aaent](http://dublincore.org/arouDs/aaents/Final%20report%20available%20online%20at%20http://dublincore.org/documents/dcmi-terms/#classes-Aaent)

FRAD - *Functional Requirements for Authority Data: A Conceptual Model- Final Report, 2008*.

FRBR - *Functional Requirements for Bibliographic Records: Final Report*. - Munich: Saur, 1998. (IFLA UBCIM publications new series; v. 19) Available on the IFLA Web site: <http://www.ifla.org/NII/s13/frbr/> (Sept. 1997, as amended and corrected through February 2008)



- GARR - *Guidelines for Authority Records and References*. 2nd ed., rev. - Munich: Saur, 2001. (IFLA UBCIM publications new series; v. 23) Available online at: <http://www.ifla.oranil/s13/aarr/aarr.Ddf>
- IME ICC -IFLA Meeting of Experts on an International Cataloguing Code (1st-5th: 2003-2007), recommendations from the participants
- ISBD - *International Standard Bibliographic Description (ISBD): preliminary consolidated edition*. - Munich: Saur, 2007. (IFLA Series on Bibliographic Control; v. 31) Available online at: <http://www.ifla.oranil/s13/DUbs/ISBD consolidated 2007.Ddf>
- RDA - *RDA: Resource Description and Access. Glossary Draft*. 5JSC/Chair/11/Rev (Jan. 2008, Table 1) Available online at: <http://www.coliectionscanada.ac.ca/isc/rda.html#drafts>
- Webster's 3rd - *Webster's Third New International Dictionary*. - Springfield, Mass. : Merriam, 1976.

### Terma që nuk përdoren

Njësi bibliografike *Shih* **Manifestim**

Emërtim *Shih* **Pikë hyrëse e autorizuar, Pikë hyrëse e kontrolluar**

Referim *Shih* **Variant i formës së emrit**

Titull uniform *Shih* **Pikë hyrëse e autorizuar, Formë e autorizuar e emrit, Emër.**



## **Rezoluta e IME ICC 2008**

Pjesmarrësit e IME ICC marrin vendim

- të bëjnë ndreqje redaktoriale kur shihet e nevojshme në tekstin e përshtatur nga pjesmarrësit e IME ICC
- të shpërndajnë tekstin tek organizmat që hartojnë rregulla dhe tek organizatat e IFLA-s, si dhe tek shtypi profesional
- të redaktojnë dhe botojnë deklaratën e ICP dhe Fjalorin, dhe t'i bëjnë ato të disponueshme falas në Web
- të sigurojnë vazhdimësinë e punës në përshtatje me plotësimet e FRAD dhe FR SAR dhe me zhvillimin e modeleve dhe skemave për të dhënat e katalogimit, dhe
- të ruajnë dokumentacionin e IME ICC dhe të ndajnë informacionin për punën dhe rezultatet e IME ICC.

Rekomandojmë gjithashtu që Seksioni i Katalogimit të IFLA-s të ngarkohet me mirëmbajtjen e teksteve dhe të drejtojë rishikimin e tyre në çdo 5 vjet për të bërë përditësimet e nevojshme, në konsultim me komunitetin më të madh të informacionit.

Përktheu Farfuri Xhaja, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë